




RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

**QENDRA E RICIKLIMIT INDUSTRIAL PËR MBETURINAT
PARAPRAKISHT TË KLASIFIKUARA OSE TË PËRZIERA**



Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Mitrovicës.

Organizatat e Shoqërisë Civile:
7Arte, CBM, IQS, CDO dhe Mundësia

RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

**QENDRA E RIKIKLIMIT INDUSTRIAL PËR MBETURINAT
PARAPRAKISHT TË KLASIFIKUARA OSE TË PËRZIERA**

Monitorues dhe autor: Erzen Isufi, Vlora Zymberi, Gentiana Zeqiri, Kenan Beqiri,
Nerimane Ferizi, Florentina Hajdari dhe Merita Mripa

Fasilitator: Visar Prebreza

Mitrovicë, Qershor 2019

PËRMBAJTJA

5	HYRJE
6	METODOLOGJIA
7	KORRIGJIMI I GABUAR I GABIMEVE
10	PAMUNDËSIMI I ANKIMIMIT
11	GABIMI KAPITAL I KOMUNËS SË MITROVICËS
12	GJUHA ITALIANE
13	KONTESTIMI I NËN-KRITEREVE
16	TË DHËNA PËR PROJEKTIN
17	REKOMANDIME

HYRJE

Grupi Monitorues ka bërë monitorim indirekt të tenderit - “Qendra e Riciklimit Industrial për Mbeturinat Paraprakisht të Klasifikuara ose të Përziera” e cila duhet ta ketë kapacitetin e përpunimit për mbeturinat paraprakisht të klasifikuara ose të përziera prej 20.000 ton/në vit¹. Ky tender është iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Mitrovicës. Komuna e Mitrovicës është ndër komunat e para që do të bëjë riciklimin e mbeturinave. Kjo komunë në pjesën e parë të vitit 2018 e kishte iniciuar tenderin për angazhimin e një kompanie që do të projektojë dhe ndërtojë fabrikën e riciklimit të mbeturinave, me një kapacitet prej 2,500 ton/në vit.

Ky tender është me vlerë të madhe, apo kontratë për punë rreth 3,5 milionë euro. Tenderi është përzgjedhur për monitorim për shkak të vlerës së madhe dhe duke marrë parasysh që puna që duhet të kryhet është në një fushë specifike siç është riciklimi i mbeturinave.

Hulumtimi i këtij tenderi është bërë në disa faza, ku përfshinë edhe disa institucione që kanë qenë të përfshira që nga inicimi e deri tek nënshkrimi i kontratës. Për këtë tender ka pasur edhe një opinion të lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Grupi Monitorues ka gjetur se në këtë proces të prokurimit disa veprime nuk janë në përputhje me ligjin e prokurimit duke e dëmtuar konkurrencën.

¹ Shih dokumentet e publikuara në ueb-faqen e KRPP- https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=160359

METODOLOGJIA

Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Mitrovicës, të cilët kanë përfiturar dije dhe aftësi praktike përmes punëtorive për aplikimin e mësimit mbi monitorimin e prokurimit publik, të organizuara nga Platforma CiviKos në kuadër të aktivitetit të USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM).

Pjesëmarrës të serisë së punëtorive ishin:

EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA
Erzen Isufi	7 Arte
Vlora Zymberi	CBM
Gentiana Zeqiri	IQS
Kenan Beqiri	CBM
Nerimane Ferizi	CBM
Merita Mripa	CDO
Florentina Hajdari	Mundësia
Visar Prebreza	Lehtësues i Punëtorive

Të gjitha këto dokumente Grupi Monitorues i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, dhe platformën elektronike për prokurim publik.

Grupi Monitorues është takuar pesë herë në zyrën e OJQ CBM në datat:

Dita I - 07.09.2018

Dita II - 26.09.2018

Dita III - 24.10.2018

Dita IV - 13.11.2018

Dita V - 24.11.2018

Qëllimet e këtyre punëtorive janë:

- Aktivizimi i OJQ-ve lokale për të monitoruar tenderët në nivel komunal;
- Aftësimi i OJQ-ve që të analizojnë gjetjet nga tenderët dhe të zbulojnë keqpërdorimet potenciale në prokurimin publik duke u mbështetur drejtpërdrejt nga lehtësuesit e angazhuar, dhe;
- OJQ-të të jenë të afta të përgatisin dhe publikojnë raporte mbi gjetjet e tyre gjatë monitorimit e prokurimit publik në nivel komunal.

KORRIGJIMI I GABUAR I GABIMEVE

Grupi Monitorues ka gjetur disa lëshime që janë bërë nga Komuna e Mitrovicës, e të cilat kanë ndikuar direkt në këtë tender.

Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Komuna e Mitrovicës nuk i ka respektuar afatet e përcaktuara në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik për rastet kur kemi përmirësim të gabimeve. Madje, ky lëshim i kishte ikur edhe vetë Organit Shqyrtues të Prokurimit, të cilët kishin konstatuar se gjithçka ishte në përputhje me ligjin e Prokurimit².
- Tenderi është iniciuar nga Komuna e Mitrovicës me datën 14 Maj 2018, me publikimin e 'njoftimit për kontratë' në faqen e prokurimit elektronik të KRPP-së. Data e fundit për dorëzimin e tenderëve ishte përcaktuar 20 Qershori 2018, ora 14:00.
- Vendosja e afatit për dorëzim të tenderëve është bërë në kundërshtim me Nenin 44, pika 2.1.1 të Ligjit të Prokurimit, i cili përcakton se për kontratat e mëdha afati i dorëzimit të ofertave duhet të jetë minimumi 40 ditë nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.
- Komuna e Mitrovicës në njoftimin e publikuar ka dhënë një arsyetim për këtë shkurtrim të afatit: "afati është shkurtuar pasi është marrëveshje dhe duhet të realizohet brenda vitit".

Pas publikimit të njoftimit për kontratë, Komuna e Mitrovicës i kishte bërë dy njoftime për korrigjim të gabimeve.

Dokumenti për korrigjimin e parë të gabimeve ishte përgatitur me datën 13 Qershor 2018. Mirëpo, ky njoftim për korrigjim të gabimeve është publikuar në "E-Prokurim" me datën 18 Qershor, apo 5 ditë më vonë se koha e përgatitjes së tij nga Komuna e Mitrovicës.

Grupi Monitorues ka gjetur se:

- Ky korrigjim i gabimeve është bërë vetëm 2 ditë para datës së fundit për dorëzimin e ofertave, në kundërshtim me rregullat në fuqi. Në këtë korrigjim ishte ndryshuar koha e dorëzimit të ofertave nga 20 qershori, në datën 26 qershor. Ky ndryshim është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi Neni 53, pika 7 thotë se me rastin e korrigjimit të gabimeve AK duhet të zgjatë afatin së paku 10 ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre.
- Ky nuk ishte korrigjimi i vetëm. Komuna e Mitrovicës e kishte përgatitur një korrigjim të ri me datën 18 qershor, në ditën kur është publikuar korrigjimi i parë që nuk ishte në përputhje me rregullat e prokurimit. Ky korrigjim i dytë ishte publikuar më shpejt në E-Prokurim. Korrigjimi është publikuar me datën 21 Qershor 2018, apo tri ditë pasi ishte përgatitur, dhe 5 ditë para datës së fundit për dorëzim të ofertave.

²Vendimi i OSHP-se, PNSH- 410/18- https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/410-18vendim_1.PDF

-
- Grupi Monitorues i ka analizuar datat kur janë publikuar njoftimet për korrigjim të gabimeve, si dhe janë krahasuar afatet e përcaktuara në Ligjin e Prokurimit dhe në Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik. Grupi Monitorues ka gjetur se Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje të dispozitave të rregullave të prokurimit. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik thonë se: “Korrigjimi i gabimeve duhet të bëhen të paktën 5 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave”. Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë vlen nga dita që publikohet në E-Prokurim, dhe jo nga data kur është përgatitur ai njoftim.

“Nëse ka ndryshime në informatat e publikuara në Dosjen e tenderit / Njoftimin e kontratës (afati i fundit të dorëzimit të tenderit, kriteret e përzgjedhje etj.) AK duhet të përgatis dhe të publikoj njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54. **Ky njoftim duhet të publikohet në sistem jo me pak se 5 ditë para afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve, në të kundërtën aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet**”, thuhet në paragrafin 25.7 – Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatja e afateve kohore të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Grupi Monitorues i Mitrovicës ka gjetur se:

- Në njoftimin për korrigjim të gabimeve që është publikuar me datën 18 qershor (2 ditë para datës së dorëzimit të ofertave), janë korrigjuar ‘Përshtatshmëria profesionale’ dhe ‘Kapaciteti teknik dhe profesional’ dhe ishte shtyrë data e dorëzimit të ofertave.
- Njoftimi për korrigjim të këtyre gabimeve ishte publikuar vetëm 2 ditë para datës së fundit për dorëzim të ofertave. Ky publikim ishte në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ, i cili kërkon që korrigjime të tilla të gabimeve duhet të bëhen 5 ditë para datës së fundit për dorëzim të ofertave.
- Tenderi që korrigjohet më pak se 5 ditë afër datës së dorëzimit të ofertave duhet të anulohet.
- Zgjatja e afatit ishte bërë për vetëm 5 ditë, ndërkohë Ligji kërkon që afati të zgjatet minimumi 10 ditë nga dita e korrigjimit.

Grupi Monitorues ka analizuar edhe korrigjimet që janë bërë në njoftimin e parë, të publikuar me datën 18 qershor. Në këtë njoftim për korrigjim të gabimeve ishte ndryshuar data e dorëzimit të ofertave. Nga data 20 qershor sa ka qenë fillimisht, dorëzimi i ofertave ishte shtyrë për datën 26 qershor.

Grupi i OJQ-ve në Mitrovicë ka gjetur se:

- Në ‘njoftimin për korrigjim të gabimeve’ janë ndryshuar kapacitetet teknike dhe profesionale, përkatësisht është larguar kërkesa që inxhinierët t’i kenë 10 vjet përvojë pune.
- “Përmirësim në Dosjen e Tenderit (DT), dhe Njoftimin për Kontratë në DT në pikat 7.1 & 7.2-Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale dhe 9.1 & 9.2 të Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe Profesionale dhe Anex 6 -Kriteret për

dhënie të kontratës largohen kriteret bazë të pika 9.1 & 9.2 dhe vendosen të Anex 6- Nën-kriteret për dhënie të kontratës për tenderin ekonomikisht më të favorshëm”, thuhet në këtë njoftim për korrigjim të gabimeve të publikuar me datën 18 qershor, vetëm dy ditë para datës së fundit për dorëzim të tenderëve.

- Kurse, në njoftimin për korrigjim të gabimeve të përgatitur me datën 18 qershor dhe publikuar me datën 21 qershor është bërë me arsyetimin se po ndryshohet data e dorëzimit të ofertave. Grupi monitorues ka gjetur se në fakt data për dorëzimin e ofertave ishte ndryshuar në ndryshim paraprak (të publikuar me datën 18 qershor). Komuna e Mitrovicës në njoftimin e dytë e ka ndryshuar datën e dorëzimit të ofertave, nga 20 qershor për datën 26 qershor .
- Korrigjimi i gabimeve që është bërë herën e parë ishte në kundërshtim me Ligjin për shkak se ishte bërë shumë vonë (vetëm dy ditë para dorëzimit të ofertave), dhe afati i dorëzimit të ofertave ishte shtyrë për 5 ditë ndërsa ligji thotë se duhet minimum 10 ditë të prolongohet afati nga dita e korrigjimit.

Në interpretimin që Grupi Monitorues e ka marrë nga Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik KRPP thuhet se afatet kohore nisin me ditën e publikimit.

“Çdo njoftim i dërguar nga AK në sistemin elektronik të prokurimit publik, sistemi e ndal 48 orë në zbatim të nenit 42 të LPP-së. Fillimi i afateve kohore për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve rregullohet me nenin 47 të LPP-së. Sipas këtij neni afati kohor i tenderimit fillon në ditën e publikimit të njoftimit në rast të procedurave të përcaktuara me nenet 33, 34 dhe 36 të LPP-së”, thuhet në interpretimin e KRPP.

Por, gjithë kjo shkelje e pretenduar është trajtuar ndryshe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Në vendimin e OSHP-së thuhet se në ‘njoftimin për korrigjim të gabimeve’ të dërguar me datën 13 Qershor dhe publikuar me datën 18 Qershor është korrigjuar vetëm data e dorëzimit të ofertave.

“Paneli shqyrtues konstaton se AK - Komuna e Mitrovicës ka përgatitur dhe dërguar për publikim në web-faqen e ‘E-Prokurimit’ me datën 13.06.2018 ‘Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54’ me të cilin formular ka korrigjuar datën e dorëzimit të ofertave nga data 20.06.2018 në datën 26.06.2018. Po ashtu AK ka përgatitur dhe dërguar për publikim në ueb faqen e e-prokurimit me datën 18.06.2018 ‘Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54’ me të cilin formular ka korrigjuar, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale dhe kapacitetin teknik dhe profesional”³.

Duke u thirrur në këtë konstatim, se në njoftimin e parë është ndryshuar vetëm data e dorëzimit të ofertave, ndërsa në njoftimin e dytë janë korrigjuar ‘Përshtatshmëria profesionale’ dhe ‘Kapaciteti teknik dhe profesional’, OSHP-ja ia ka hedhë si të paqëndrueshme pretendimet e Operatorit Ekonomik “TEHNIX” doo - Kroaci dhe “TEHNIX” doo — Maqedoni.

³ Vendimi i OSHP-se, PNSH- 410/18- https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/410-18vendim_1.PDF

Grupi Monitorues i Mitrovicës ka gjetur se:

- Në korrigjimin e dërguar me datën 13 Qershor, janë korrigjuar ‘Përshtatshmëria profesionale’ dhe ‘Kapaciteti teknik dhe profesional’. Por, në të njëjtin njoftim ishte ndryshuar edhe data e dorëzimit të ofertave, nga data 20 Qershor, dorëzimi i ofertave ishte shtyrë për datën 26 Qershor. **Marrë parasysh se korrigjimi i gabimeve duhet të bëhet së paku 5 ditë para ditës së fundit për dorëzim të ofertave, kjo nuk është plotësuar në këtë rast. Pra, Komuna e Mitrovicës nuk i ka respektuar afatet e përcaktuara në Ligjin e Prokurimit.**

“Paneli shqyrtues konsideron se kur merret parasysh data e dërgimit për publikim dhe publikimet e tyre në web e E-prokurimit të formularëve standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara nga Komuna e Mitrovicës konstatohet se janë bërë korrigjimet përmes këtyre formularëve 5 ditë para dorëzimit të ofertave konform rregullave për prokurim publik”, thuhet në vendimin e OSHP-së.

Këto konstatime të bëra në vendimin e OSHP-së janë të pabazuara, gjë që e vë në dyshim komplet bazën e vendimit të OSHP-së për të lejuar komunën e Mitrovicës të vazhdojnë me këtë aktivitet të prokurimit. OSHP-ja me apo pa dashje ka marrë për bazë fakte të paqena për të vendosur në favor të Komunës së Mitrovicës.

OSHP-ja, përveç këtij konstatimi, thotë se Operatori Ekonomik ankues për pretendimet në ‘njoftim për kontratë’ duhet të bëhen bazuar në nenin 108/A të Ligjit të Prokurimit. Paneli shqyrtues konsideron se pretendimet e tilla është dashur të parashtrihen nga OE ankuese në fazën e ‘njoftimit për kontratë’ para dorëzimit të ofertave.

PAMUNDËSIMI I ANKIMIMIT

Grupi Monitorues i Mitrovicës ka gjetur se:

- Korrigjimi i fundit i gabimeve është publikuar në web-faqen e KRPP-së me datën 21 qershor. Në një interpretim dhënë Grupit Monitorues, KRPP-ja thotë se fillimi i afateve kohore për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, dhe tenderëve rregullohet me nenin 47 të LPP-së. Sipas këtij neni afati kohor i tenderimit fillon në ditën e publikimit të njoftimit në rast të procedurave të përcaktuara me nenet 33, 34 dhe 36 të LPP-së.
- E korrigjimi i fundit është publikuar (21 Qershor 2018) saktësisht 5 ditë para afatit të fundit (26 Qershor 2018) për dorëzim të tenderëve. Ky korrigjim ishte bërë në kundërshtim me nenin 53, pika 7 e Ligjit të Prokurimit Publik, i cili kërkon që pas korrigjimit të një gabimi, AK duhet të shtyjë për të paktën 10 ditë kohën e dorëzimit të ofertave. Pra, pas secilin ndryshim të Dosjes së Tenderit, AK duhet t’ia lë të paktën 10 ditë operatorëve ekonomik të dorëzojnë ofertat e tyre.
- Duke e shtyrë afatin e dorëzimit të ofertave për vetëm 5 ditë, autoriteti kontraktues përveç shkeljes së nenit 53.7 ia ka pamundësuar ankesën Operatorit Ekonomik. Neni 108/A i Ligjit të Prokurimit publik ia mundëson OE paraqitjen

e 'kërkesës për rishqyrtim' pranë autoritetit kontraktues, pra është faza e parë e ankimit, ndërsa, paragrafi 3 i këtij neni i ka rregulluar afatet kohore kur mund të bëhet ankesa në shkallën e parë.

- Për pretendimet që kanë të bëjnë me 'njoftimin për kontratë', kërkesa për rishqyrtim duhet të dorëzohet 5 ditë para ditës së fundit për dorëzim të ofertave.
- "Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: 3.1. në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave"⁴.

Grupi Monitorues ka kërkuar interpretim nga KRPP-ja për afatin kur duhet të dorëzohet kërkesa për rishqyrtim të AK për shkeljet e pretenduara tek njoftimi për kontratë.

"Bazuar në paragrafin 4.1 pika (a) të Rregullave të lartë përmendura kur kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit ajo duhet të parashtrohet se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave."⁵

Bazuar në datat e publikimit të korrigjimit të fundit, del që operatori ekonomik e ka pasur në dispozicion vetëm një ditë për t'u ankuar, pasi korrigjimi i fundit është bërë me datën 21 qershor, kurse afati i fundit për dorëzim të ofertave ka qenë me datën 26 qershor.

GABIMI KAPITAL I KOMUNËS SË MITROVICËS

Njëra prej çështjeve të kontestuara në këtë tender është një gabim i lëshuar nga Komuna e Mitrovicës në "Njoftimin për Kontratë" në versionin në gjuhën angleze.

Komuna e Mitrovicës ka lëshuar një gabim me rastin e hartimit dhe bashkëngjitjes në e-prokurim tek pjesa e përshkrimit të çmimeve në gjuhën angleze të tabela "Rekapitulimin nuk e kanë përshkruar pjesën shpenzimet e doganës (8%) në strukturë Metalike, Aparate ("Makineri) dhe Pajisje". Pra, në tabelën e Excel nuk janë kalkuluar fare shpenzimet e doganës në vlerë prej 8%, e kjo ka bërë që operatorët që kanë aplikuar duke u bazuar në dosjen në gjuhën angleze të ofertojnë gabimisht, pra pa i kalkuluar shpenzimet doganore.

Kjo është konstatuar edhe nga Eksperti shqyrtues, i cili ka sqaruar se OE ankuese ka dorëzuar tabelën e përshkrimit të çmimeve në gjuhën angleze ashtu siç e ka bashkëngjitur AK në e-prokurim pa dhënë respektivisht llogaritur shpenzimet e doganës (8%) në Strukturë Metalike, Aparate ("Makineri) dhe Pajisje", ndërsa operatori ekonomik i shpallur fitues ka dorëzuar dosjen e tenderit respektivisht tabelën e përshkrimit e çmimeve në gjuhën shqipe ashtu siç e ka bashkëngjitur AK në E-prokurim duke thënë respektivisht llogaritur edhe shpenzimet e doganës (8%) në strukturë: metalike, aparate ("makineri) dhe pajisje".

⁴ Ligji I Prokurimit Publik paragrafi 3, neni 108/A.

⁵ Përgjigja e KRPP-së dhënë Rrjetit të OJQ-ve të Rajonit të Mitrovicës.

Grupi Monitorues ka kërkuar një sqarim nga Komuna e Mitrovicës për gabimin e lëshuar në dokumentet në gjuhën angleze, duke mos e vendosur shpenzimet e doganës prej 8%. Ata e kanë përmendur këtë fakt si gabim të Operatorit Ekonomik ankues.

“O.E.TEHNIX nuk ka llogaritur 8 % të Doganës në ofertën bazë, d.m.th formulari i tenderit nuk është si duhet ose mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacione shtesë (kusht Administrativ)”, thuhet në përgjigjen e dhënë nga Komuna e Mitrovicës⁶.

Por, Grupi Monitorues ka kërkuar përgjigje shtesë nga Komuna e Mitrovicës, duke insistuar të marrë përgjigje për gabimin në versionin anglisht të dosjes së tenderit.

Haxhimet Ferati – Menaxher i Prokurimit në Komunën e Mitrovicës serish ka insistuar⁷ se OE ankues nuk e ka rekapitullimin prej 8% të shpenzimeve të Doganës në strukturën metalike. Ai insiston se OE ka pasur mundësi të ofertojë në tri gjuhët zyrtare, dhe jo vetëm në gjuhën angleze ku kishte gabim. OE ankues nuk ka kërkuar sqarime gjatë fazës së tenderimit për këtë çështje.

Thotë se përfaqësuesit e kompanisë kanë qenë shqiptar të Maqedonisë, ndërsa thotë se gabim “një fjali ka qenë, nuk ka qenë një libër”. Ai thotë se gjuha shqipe është “gjuha (zyrtare) dominuese në tender në Kosovë.

Por, ai insiston se Komuna e Mitrovicës nuk ka bërë asnjë gabim, përkundër që gabimi është konfirmuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe vet ai më lartë e pranon se gabimi ka qenë vetëm në një fjali.

“Këtu nuk ka kurrfarë gabimi nga ana e Komunës së Mitrovicës nga Zyra e Prokurimit sepse njoftimi është publikuar në E-Prokurim dhe kanë pas qasje të gjithë O.E. konkurrues në tender”⁸.

Në bazë të shpjegimeve të dhëna nga KRPP-ja, Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara të përmirësojnë normën e TVSH-së në rast se një OE e ka gabuar në ofertën e tyre. Një gjë të tillë, Komuna e Mitrovicës nuk e ka bërë. Për më tepër, komuna e Mitrovicës gabimisht e ka hartuar DT në gjuhën angleze ashtu që OE nuk e ka vendosur fare TVSH-në meqë atë nuk e kishte vendosur AK-së.

Komuna e Mitrovicës nuk e ka përmirësuar TVSH-në në ofertën e OE, por e ka cilësuar atë si shkelje të bërë nga Operatori Ekonomik.

GJUHA ITALIANE

Operatori i rekomanduar për kontratë kishte dorëzuar një pjesë të ofertës së tyre në gjuhën italiane. Dorëzimi i ofertës në gjuhë tjetër, përveç tri gjuhëve zyrtarëve, është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit. Neni 13, i Ligjit të Prokurimit, e rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare në dokumentet e prokurimit publik siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 13 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili thotë: “Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.”

⁶ Përgjigja me shkrim e Komunës së Mitrovicës dhënë për grupin monitorues .

⁷ Po aty

⁸ Intervistë me Haxhimet Ferati – Menaxhere e prokurimit në Komunën e Mitrovicës; 5 dhjetor 2018

Operatori Ekonomik ankues, siç është thënë në vendimin e OSHP, pretendon se Komuna e Mitrovicës duke pranuar ofertën në gjuhën italiane e ka shkelur Ligjin e Prokurimit. Këtë pretendim e kishte shqyrtuar OSHP-ja. Pretendimet e operatorit ekonomik ankues, sipas OSHP-së janë pjesërisht të bazuara, pasi vetëm një pjesë të dosjes së OE të rekomanduar për kontratë ishte në gjuhën italiane.

“AK - Komuna e Mitrovicës me rastin e vlerësimit të ofertave përjashtimisht që disa dokumente të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues i ka pranuar vetëm në gjuhën Italiane, të cilat kanë qenë të kuptueshme por pa qenë të përkthyer në njërin nga gjuhët (shqip, serbisht apo anglisht) siç parashihet me nenin 13 të LPP-së, dokumentacionin tjetër të dorëzuar nga OE i shpallur fitues e ka pranuar, sepse ka qenë konform kërkesave dhe dëshmime të parashtruara nga AK në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit”⁹.

Grupi Monitorues ka kërkuar përgjigje nga Komuna e Mitrovicës për çështjen e dorëzimit të një pjesë të ofertës në gjuhën italiane nga ana e OE të rekomanduar për kontratë. Ata kanë thënë se kanë angazhuar përkthyes.

“Në rastin konkret neve nuk na është dashtë shumë përkthimi, sepse nga gjuha italiane kemi pasur shifra dhe terma ekonomik dhe vizatime të makinerisë dhe foto të cilat duhet të vendosen dhe kemi angazhuar nga jashtë përkthyes për përkthim të dokumentacionit të kërkuar”.

Pas kësaj përgjigje, Grupi Monitorues ka kërkuar përgjigje shtesë duke i pyetur se si është angazhuar përkthyesi i gjuhës italiane, cila kompani është angazhuar dhe sa ka qenë kosto? Por, Komuna e Mitrovicës nuk ka kthyer përgjigje në këto pyetje.

KONTESTIMI

Komuna e Mitrovicës kishte vendosur që “çmimi ekonomikisht më i favorshëm” të jetë kriter për dhënie të kontratës. Ky kriter për dhënie të kontratës përveç çmimit i merr në konsideratë edhe nën-kriteret të tjera për t’i vlerësuar ofertat duke ju dhënë atyre peshë të caktuar në vlerësim.

Ligji i Prokurimit Publik kërkon që nën-kriteret duhet të jenë të qartë, të matshme dhe realiste.

Neni 52 i Ligjit të prokurimit Publik e rregullon çështjen e njoftimit të kriterëve për dhënien e kontratës. AK obligohet që në rastet kur kriter për dhënie është “Çmimi Ekonomikisht më i Favorshëm”, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre.

“Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret të tilla mund të jenë në lidhje me p.sh., cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbi-

⁹ Vendimi i OSHP-se, PNSH- 410/18- https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/410-18vendim_1.PDF

met e pas-shitjes dhe asistencë teknike”, thuhet në paragrafin e dytë të nenit 52 të Ligjit të Prokurimit.

Tutje, në paragrafin pasues, thuhet se autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëjë një dallim të qartë në mes nën-kritereve dhe kërkesave profesionale, financiare dhe teknike.

Lidhur me tenderin e iniciuar nga Komuna e Mitrovicës, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte lëshuar një opinion. Kishte konstatuar se: **“Kriteret e vendosura ishin në kundërshtim me ligjin në tenderin- “Projektimi dhe kryerja e punëve në ndërtimin e qendrës së riciklimit industrial për mbeturinat komunale para-prakisht të klasifikuara ose të përziera në Mitrovicë, me kapacitet deri në 10t/h”.**

Agjencia kundër Korrupsionit kishte konstatuar se nën-kriteret për dhënien të kontratës tek pjesa e ofertës teknike ishin identike me përzgjedhjen në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike.

“Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën-kriterit për dhënie të kontratës nr: 2 oferta teknike, nuk ka respektuar nenin 52 paragrafi 4 të LPP-së, për arsye se autoriteti kontraktues kriteret e lartë cekura i ka specifikuar edhe si kërkesa të përzgjedhjes të cilat duhet të plotësohen që një tender të konsiderohet i përgjegjshëm, por edhe si nën-kriter për dhënie të kontratës, andaj sipas nenin të lartcekur autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes të kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike dhe kritereve për dhënie të kontratës, dhe nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve”¹⁰.

Agjencia kundër Korrupsionit, në opinionin e vetë i ka rekomanduar Komunës së Mitrovicës që kriterin për dhënie të kontratës duhet t’i caktojë nën-kritere të qarta, precize dhe të matshme.

Pas këtij opinion, Komuna e Mitrovicës e kishte ndryshuar njoftimin për kontratë, ku i kishte hequr si kërkesa teknike dhe profesionale, ndërsa të njëjtat kishin mbetur tek nën-kriteret për dhënie të kontratës.

Agjencia Kundër Korrupsionit nuk e ka bërë një opinion të dytë për të parë nëse Komuna e Mitrovicës e ka zbatuar rekomandimin e tyre.

Sa i përket nën-kritereve nuk kishte ankesë në shkallën e parë, pra kërkesë për rishqyrtim bazuar në nenin 108/A të Ligjit të Prokurimit Publik. Por, kjo çështje ishte përmendur në panelin shqyrtues të OSHP-së që është mbajtur për këtë çështje. Kompania ankuese kishte pretenduar se nën-kriteret për dhënie të kontratës kishin qenë të kundërligjshme. Këtë e kanë mbështetur në rezultatet që kanë prodhuar ato nën-kritere.

Grupi Monitorues ka kërkuar qasje në raportin e komisionit vlerësues për të parë mënyrën e poentimit, për të parë nëse kompania ankuese kishte bërë konstatim të drejtë. Komisionit Vlerësues i Komunës së Mitrovicës i kishte poentuar njëjtë të dy kompanitë në të gjithë nën-kriteret përveç çmimit të ofertuar.¹¹

“Ne kemi argumentuar që atë që e ka menduar AK, kriteret e përcaktuara nuk kanë të

¹⁰ Opinioni i Agjencisë kundër Korrupsionit, datë 23 maj 2018

¹¹ Raporti i komisionit Vlerësues, fq . Ky raport është siguruar duke u bazuar në Ligjin për Qasjen në Dokumentet Publike.

bëjnë fare me kriteret që vendosen për tender ekonomikisht më të favorshëm. Kriteret që janë vendosur dhe që AK i ka përdorur për vlerësim të OE të paktën është dashur të përdoren sipas peshës që e kanë dhënë. Ky është raporti për tenderin ekonomikisht më të favorshëm prej AK për dy OE-të dhe është identik, si për fituesin si për ne që nuk jemi shpallur fitues. Ky vlerësim i barabartë në nën-kritere ka bërë që prapë vendimtar në vendimin për dhënien e kontratës të jetë çmimi më i ulët.”¹²

Komisioni vlerësues njëhën prej kompanive e ka shpallur të papërgjegjshme për shkak të disa shkeljeve të bëra.

Komuna e Mitrovicës i bënë përgjegjës KRPP për nën-kriteret e përgatitura nga ta. Por, në fakt është përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për kontrollin e nën-kritereve, kushteve teknike dhe profesionale.

“Dhe në fund ju sqarojmë se i gjithë ‘Njoftimi për Kontratë’ si dhe DT janë përgatitë sipas sugjerimeve të KRPP-së, e cila i monitoron të gjitha publikimet (vlera të mëdha gjithësesi) dhe Agjencia Kundër Korrupsionit ku jemi sqaruar për nën-kritere.”¹³

KRPP-ja tenton të shfaqësohet për nën-kriteret e vendosura, duke mos dhënë një vlerësim për to.

“Kriteret për dhënie të kontratës përcaktohen nga AK në përputhje me nenin 52 të LPP-së”¹⁴.

Neni 52 thotë se në rastet kur kriter për dhënie të kontratës është “çmimi ekonomikisht më i favorshëm, AK duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter.

IV.2) KRITERET E DHËNIES

<input type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët	
	<i>ose</i>	
<input checked="" type="checkbox"/>	Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të	
Nënkriteret		Koeficient
1	Çmimi	
2	Ofeta Teknike	
3	1(një)Ing i Dipl. i Ndërtim-Projekt Menaxher –Poentimi në bazë të përvojës.	
4	1(një)Ing i Dipl. i Teknologj. ose Master–Poentimi në bazë të përvojës.	
5	1(një)Ing i Dipl. i Makinerisë ose Master–Poentimi në bazë të përvojës.	
6	1(një)Ing i Dipl. i Hidros. Ose Master–Poentimi në bazë të përvojës.	
7	1(një)Ing i Dipl. i Strukturave Ose Master–Poentimi në bazë të përvojës.	
8	Ing te Ambientit te licencuar nga MMPH me VNM-Poentimi në bazë te përvojës.	
9	Metodologjia e punës	
10	Plani Dinamik	
11	Lista e punëtorve min 50 Poentimi në bazë te numrit të punëtorve	
12	Lista e makinerisë	

¹² Fjala e përfaqësuesit të kompanisë ankuese e mbajtur në Panelin Shqyrtues të OSHP-së dhe që është përshkruar në vendimin e OSHP-së me nr: 410/18

¹³ Përgjigja e Komunës së Mitrovicës dhënë me datën 08.10.2018 përmes Haxhimet Ferati.

¹⁴ Përgjigja e KRPP- Departamenti i Rregullave-KRPP, 18 tetor 2018.

TË DHËNA PËR PROJEKTIN

Në njoftimin për kontratë është thënë se është veçanërisht e nevojshme përzierja, me një kapacitet prej 2500 ton/në vit, e bio-mbeturinave të ndara dhe grumbulluara dhe mbeturinave organike të ndara nga mbeturinat e përziera komunale, dhe mbeturinat e gjelbra, pulpi, mbeturinat tropikale, llumi inert nga impiantet për pastrimin e ujit. **I tërë procesi teknologjik duhet të realizohet në kushte të kontrolluara mjedisore pa ndonjë ndikim negativ ndaj mjedisit.**

Kërkesa e Komunës së Mitrovicës është që mbeturinat komunale grumbullohen në baza ditore dhe dërgohen në qendrën e përpunimit.

“Të gjitha mbeturinat e grumbulluara duhet të trajtohen në të njëjtën ditë pa depozitim brenda mbylljes, pasi që kjo do të krijonte një masë eksplozive të gazit (metan), që do të mund ta rrezikonte sigurinë e impiantit. Dizajnimi i projektit parasheh një impiant për mbeturinat paraprakisht të trajtuara dhe të përziera me një kapacitet prej 10 ton.

Është paraparë që funksionimi i impiantit do të bëhet në një ose në dy ndërrime, varësisht nga kapaciteti i grumbullimit të mbeturinave. Zgjidhja e propozuar teknologjike do të ishte riciklimi i mbeturinave sipas Planit për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës dhe hapësirat e nevojshme për përpunimin teknologjik të mbeturinave të ngurta që dërgohen.

Për riciklimin e mbeturinave, është e nevojshme një hapësirë me gjatësi prej 140 metra dhe gjerësi prej 55 metra, e rrethuar me një rrethojë me lartësi prej 2 metra.

1. Impianti për riciklimin e mbeturinave industriale ka një kapacitet prej 10 t/h. Ai përfshinë grumbullimin e mbeturinave, hapjen e qeseve, sistemin e largimit të lagështisë dhe nxjerrjen e mbeturinave të vogla organike, përgatitjen, klasifikimin e mbeturinave të pastruara komunale, dhe klasifikimin e 8 llojeve të mbeturinave të papërpunuara në linjën e klasifikimit.

Klasifikimi manual i materialeve të papërpunuara me një pastërti prej 98% mundëson shitjen e materialeve të papërpunuara në tregun global dhe sigurimin e një çmimi të mirë. Klasifikimi bëhet me dy duart në dy spango në kutitë për materialet e papërpunuara. Kjo na mundëson arritjen e kapacitetit të dyfishtë të klasifikimit për një punëtor.

Riciklimi i mbeturinave paraprakisht të klasifikuara dhe të përziera kryhet në linjën e njëjtë të klasifikimit të materialit të papërpunuar sipas këtij rendi: plastika, kartoni, letra, PET, MET, tekstili, qelqi dhe metali. Të gjitha materialet e papërpunuara vihen në dengje ose paketohen për shitje në treg. Nga e tërë masa e mbeturinave, 80% riciklohet përmes procesit automatik.

-
2. Impianti për grisje dhe paketim në dengje për karburant që buron nga mbeturinat. Të gjitha mbeturinat e vogla të djegshme dhe paketimet e veçanta të tetrahedronit, paketimit shumë shtresor, pelenave, lodrave dhe të gjitha llojeve të kauçukut të djegshëm, lëkurës, këpucëve, tekstilit, ndriçuesve të rrugës dhe mbeturinat tjera komplekse shumë shtresore të djegshme mbesin në një konvejer të klasifikimit, pasi që klasifikimi i nënshtrohet një rrjedhe të vazhdueshme deri në prerje me gjerësi prej 30 mm.

Kështu që mbeturinat paraprakisht të thara dhe grisura transportohen për paketim automatik në dengje dhe pastaj dengjet mund të deponohen lehtë, të transportohen në treg si energji me një vlerë energjetike prej 4 MW për ton, që zëvendësojnë karburantet fosile. Karburanti i tillë është ideal si një burim energjie për prodhimin e çimentos.

REKOMANDIMET

- Udhëheqësi i Prokurimit duhet të sigurohet që tenderët e rinj të hapen në përputhje me ligjin sa i përket afateve për dorëzim të ofertave.
- Pas secilin korrigjim të gabimeve të bëhet, Komuna duhet t'i shtyjë afatet për dorëzim të ofertave në përputhje me ligjin.
- Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që lëshime të tilla nga stafi i prokurimit të sanksionohen në mënyrë që të parandalohet diskriminimi i OE, përkatësisht kufizimi i konkurrencës që rrezikon rritjen e çmimeve.
- Udhëheqësi i Prokurimit në mënyrë direkte dhe Kryetari në mënyrë indirekte duhet të sigurohen që publikimet e të gjitha dokumenteve të tenderëve të jenë të njëjta në tri gjuhët zyrtare për të parandaluar diskriminimin e bizneseve të huaja.
- Udhëheqësi i Prokurimit duhet të sigurohet që ofertat t'i pranojë vetëm në gjuhët zyrtare.
- Paneli shqyrtues i OSHP-së duhet të sigurohet që mos të lëshojë gabime kapitale në vendimet e tyre.
- Eksperti Shqyrtues duhet të sigurohet që të bëjë analiza dhe ekspertiza në bazë të fakteve.

